



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**



**VENDIM**

Nr. 40 datë 28.06.2021

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË  
STREHIMIT "SUBVENCIONI I QIRASË, NË TREGUN E LIRË"**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutë, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "n", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore" Ligji nr 22/2018 " Për strehimin social"; VKM nr 384 datë 12.06.2019 " Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM nr 362, datë 29.05.2019 " Për kriteret e dhënies së subvencionit të Qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKM nr 301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët" Planin Social Vendore miratuar me VKB nr 84 datë 24.12.2020; me propozimin të Kryetarit të Bashkisë :

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI**

1. Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencioni i Qirasë në tregun e lirë .
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETAR  
Mark BISHA

  
Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Ardian ÇELEPIJA



Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me Datë 02.07.2021